

VENDIM
Nr. 316, datë 9.12.2022

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13, pika 1, dhe 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/2 prot., datë 7.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Në vijim të relacioni nr. 2039/2 prot., datë 7.2.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, lindi nevoja për sqarime që lidhen me dokumentacionin financiar të aplikimit të shoqërisë dhe si e tillë vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 20 (njëzet) ditë pune, për t’iu drejtuar shoqërisë me shkresën respektive, në lidhje me dhënien e sqarimeve për këto çështje. Brenda 10 (dhjetë) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës, që vërteton mbështetjen financiare për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 (njëzet) ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës që vërteton mbështetjen financiare për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

